



GRATË NË INSTITUCIONET E SIGURISË SË KOSOVËS

Realizimi i katalogut u mbështet nga
Ambasada Mbretërore Norvegjeze në Kosovë.



NORWEGIAN EMBASSY

Mirënjohje e veçantë për mbështetje, bashkëpunim të mirëfilltë dhe
konsultim, i dedikohet:
UNWOMEN, ICITAP, NAT dhe OSBE



Prishtinë, dhjetor 2014

Hyrje

Ky është një projekt i përbashkët i katër ministrive të Qeverisë së Republikës të Kosovës, me qëllim të promovimit të katër agjencive të saj, si: Policia, Forca e Sigurisë, Dogana dhe Shërbimi Korrektues i Kosovës.

Ky bashkëpunim i katër agjencive, është bërë me qëllim të fuqizimit të rolit të gruas, ngritjes së vetëdijes dhe vënies në pah të kontributit që gratë japin për sigurinë, me qëllim motivimin e grave që të zgjedhin profesione në uniformë.

Megjithatë, sot gratë ia kanë dalë që me krenari dhe profesionalizëm të lartë, në kuadër të detyrave të tyre të punës, të jenë partner i barabartë me meshkujt dhe kështu japin kontributin e tyre për sigurinë e qytetarëve dhe për të mirën e vendit.

Gruaja sot është e përfshirë në të gjitha organizatat dhe jep kontributin e saj në të gjitha nivelet drejtuese, në organizata si: Policia, Forca e Sigurisë, Dogana dhe Shërbimi Korrektues.

MINISTRIA E FORCËS SË SIGURISË / FORCA E SIGURISË SË KOSOVËS

Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) është Forcë e re, profesionale, shumetnike, lehtë e armatosur dhe e uniformuar e Sigurisë e cila i nënshtrohet kontrollit demokratik, civil dhe e cila është themeluar më 21 janar 2009, gjithsejt ka 2500 pjesëtarë aktivë dhe 800 pjesëtarë rezervë.

Misioni i FSK-së është që të kryej operacionet e reagimit ndaj krizave në Kosovë dhe jashtë saj; operacionet e mbrojtjes civile brenda Kosovës; si dhe t'i ndihmoj autoriteteve civile në përgjigje ndaj katastrofave natyrore dhe emergjencave të tjera. Detyra të tilla do të përfshijnë operacionet e kërkim shpëtimit; mënjanimin e mjeteve shpërthyes; kontrollin dhe pastrimin e materieve të rrezikshme; zjarrfikjen; si dhe detyrat tjera të ndihmës humanitare. FSK-ja do t'i përfaqësoj dhe mbroj të gjithë njerëzit e Kosovës.

Zhvillimi i FSK-së është i bazuar në praktikat më të mira demokratike për të siguruar një "forcë për të mirë", që është nën kontrollin demokratik civil dhe është e pranueshme për kombin, fqinjët, dhe NATO.

Fushatat e rekrutimit të FSK-së i inkurajojnë pjesëtarët e komuniteteve etnike dhe femrat që të bëhen pjesë e FSK-së. Femrat në uniformë shërbejnë në të gjitha njësitë e FSK-së: në Komandën e Forcave Tokësore, Brigadën e Mbështetjes Operacionale, Brigadën e Reagimit të Shpejtë, Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes, njësitë vartëse pranshtabore si dhe në Ministrinë e Integruar të Forcës së Sigurisë së Kosovës (MFSK).

Në MFSK dhe në FSK, barazia gjinore përfshihet në zbatimin e politikave dhe planeve në çdo nivel, dhe të dy institucionet janë të përkushtuara që t'i zbatojnë parimet dhe politikat e tilla.

MINISTRIA E FINANCAVE / DOGANA E KOSOVËS

Një ndër institucionet e para të krijuara pas përfundimit të luftës në vitin 1999 në Kosovës ishte Dogana e cila zyrtarisht filloi punën me datën 3 shtator 1999. Është themeluar si Shërbimi Doganor i UNMIK-ut nga shtylla e BE-së, për të siguruar aplikimin e drejtë e të njëtrajtshëm konform të rregullave doganore dhe dispozitave të tjera. Kështu, pas një procesi të tranzicionit me 12 dhjetor 2008 Shërbimi Doganor i UNMIK-ut u shndërrua në Doganën e Kosovës. Kodi i ri doganor është miratuar me 11 nëntor 2008 nga Kuvendi i Kosovës që dhe mundësoi këtë tranzicion. Dogana e Kosovës është zhvilluar në mënyrë progresive dhe përmban çdo element të Doganës moderne prej themelimit të saj, në kontrollin e të hyrave, ngritjen dhe zhvillimin e sistemeve, promovimin në komunikim dhe bashkëpunimin me komunitetin e biznesit, ndërtimin dhe profesionalizimin e kapaciteteve njerëzore, inteligjencën dhe elementet anti-kontrabandë, politikën dhe njësitë ligjore së bashku me funksionet e Drejtorisë qendrore.

Ndonëse ende nuk është anëtar i plotë në organizatat ndërkombëtare, merr pjesë në të gjitha iniciativat ndërkombëtare dhe regjionale, nën programin e asistencës së Komisionit Evropian dhe iniciativës së bashkëpunimit të Evropës Juglindore (IBEL).

Dogana ka një mision të gjerë, duke filluar nga mbrojtja e shtetit, ekonomisë dhe qytetarëve. Misioni i Doganës ndahet në dy kategori kryesore: KONTRIBUTI NË ÇËSHTJET EKONOMIKE dhe KONTRIBUTI PËR SIGURINË.

Dogana e Kosovës vjel rreth 70% e të hyrave të Buxhetit të të Kosovës me një mesatare 1 cent shpenzime për 1 euro të mbledhur. Përveç vjeljes së të hyrave, Dogana e Kosovës e mbron shoqërinë nga kontrabandimi i drogës dhe mallrave tjera të ndaluara me efekt të dëmshëm të krimit ekonomik si dhe evazionit në të hyra.

MINISTRIA E DREJTËSISË/SHËRBIMI KORREKTUES I KOSOVËS

Shërbimi Korrektues i Republikës së Kosovës është themeluar në vitin 1999, në kuadër të shtyllës së parë të drejtësisë, fillimisht duke funksionalizuar Qendrën e Paraburgimit në Prizren për të vazhduar me konsolidimin e infrastrukturës në Institucionet tjera si; Dubrava, Gjilani, Lipjani, Peja, Mitrovica, Prishtina, Smrekonica si dhe me ndërtimin e Qendrës së Paraburgimit Lipjan dhe Burgut të Sigurisë së Lartë në Gërdovc.

Shërbimi Korrektues ka strukturën e vet dhe ka këto njësi themelore organizative: Drejtoria Qendrore me seli në Prishtinë dhe Institucionet korrektuese. Zyra Qendrore e Shërbimit Korrektues, e përcjell, e mbikëqyr ligjshmërinë e punës dhe të veprimit të njërive organizative të Shërbimit Korrektues dhe të Institucioneve korrektuese.

Misioni i SHKK-së është risocializimi i personave të dënuar dhe me masë edukuese korrektuese gjatë mbajtjes së dënimit dhe riintegrimi i tyre në shoqëri, gjithmonë duke respektuar të drejtat e tyre fundamentale pa marrë parasysh racën, gjuhën dhe religjionin si dhe siguron një ambient të sigurt për stafin, të burgosurit dhe shoqërinë.

Vizioni i SHKK-së është zhvillimi i një Shërbimi të avancuar, i cili do të funksionojë në përputhje me ligjin, normat dhe standarde ndërkombëtare.

Shërbimi Korrektues është i vendosur në promovimin e barazisë në të gjitha sferat e punës , vepron duke respektuar barazinë gjinore, përkatësin kombëtare, të drejtën e mendimit dhe besimit, statusin social etj. Këto janë dëshmuar në personelin e punësuar si dhe të burgosurit nën kujdesin tonë.

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME / POLICIA E KOSOVËS:

Bazuar mbi parimet më të avancuara të të drejtave të njeriut dhe standardeve të zbatimit të ligjit, me përkrahjen e institucioneve vendore dhe ndërkombëtare, në Shtator 1999 është themeluar Policia e Kosovës, si institucion i zbatimit të ligjit i ndërtuar mbi vlerat të cilat, mbi të gjitha, promovojnë standardet më të avancuara profesionale, si dhe ato që kanë të bëjnë me përfaqësimin e femrës dhe rolin e saj të merituar në një organizatë siç është PK-ja.

Misioni i Policisë së Kosovës është të ofroj zbatim të ligjit në Kosovë në mënyrë profesionale, efektive dhe efikase. Objektivat strategjike të këtij institucioni janë: Të mbroj jetën dhe pronën, të mbaj rendin dhe qetësin publike, të parandaloj dhe zbulojë krimin, të mbrojë të drejtat dhe liritë e njeriut dhe t'i trajtojë në mënyrë të barabartë të gjithë qytetarët pa dallim race, ngjyre, religjioni, gjinie dhe moshe. Sipas strukturës organizative aktuale, Policia e Kosovës është e organizuar në dy nivele: niveli qendror dhe lokal.

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë është niveli qendror përgjegjës për tërë Republikën e Kosovës. Niveli lokal përfshinë Drejtoritë Rajonale të Policisë, përgjegjëse për rajonet e përbëra me komunat e caktuara, stacionet policore që janë përgjegjëse për policinë lokale në secilën komunë dhe nënstacionet policore – përgjegjëse për policinë lokale brenda zonave të caktuara të një komune.

Zbatimi i standardit të ri kulturor të Policisë së Kosovës si dhe krijimi e promovimi i vlerave, e kanë shndërruar këtë institucion në një shembull për të gjitha institucionet dhe dëshmi se, barazia gjinore nuk është vetëm një shprehje jona retorike, por një realitet të cilin duhet thelluar dhe avancuar përditë.

Duke bazuar në kapacitetet dhe vullnetin e femrave në polici, përkrahjen e vazhdueshme të menaxhmentit në PK, si dhe institucioneve dhe organizatave të tjera e në veçanti nga UNWomen, është arritur edhe krijimi i Shoqatës së Grave në Policinë e Kosovës e cila tashmë është e anëtarësuar në organizata të tilla ndërkombëtare.

Shoqata e Grave të Policisë së Kosovës në radhët e saja aktualisht numëron afro 500 anëtarë dhe në këtë numër janë të përfshirë staf i uniformuar, civil si dhe anëtarë meshkuj.



Forca e Sigurisë së Kosovës

Valbona Kerolli

Pozita: Kapter, Infermiere në Kompaninë e Mjekësisë

Kompania e Mjekësisë, ka tri ekupe evakuimi të cilat janë çdoherë në gjendje gatishmërie për reagim, unë jam përgjegjëse për procedurat e veprimit, gjithmonë në koordinim me eprorët varësisht prej situatës ku dhe si duhet të veprojmë.

Për të dëshmuar vlerën dhe rëndësinë që ka uniforma, unë ndërpreva çdo angazhim nga jeta civile, me qëllimin e vetëm për kontribut sa më të madh në jetën ushtarake.

Po sigurisht, faktet tregojnë si në kohën e luftës, ashtu edhe në paqe ne vazhdojmë punën tonë, ku para pak kohësh unë isha pjesë e stafit akademik në ushtrimin fushor që u mbajt në Slloveni, ku morën pjesë shumë shtete.

Është një punë e vazhdueshme duke iu falënderuar gjithmonë familjes, jam e martuar kam dy fëmijë, njëkohësisht vazhdoj studimet Master në Fakultetin Juridik, ku tani jam në përfundim.

Gjatë punës që bëjmë në teren në bashkëpunimin edhe me organizata të ndryshme ata ndjejnë kënaqësi, madje kanë edhe besim në shërbimin tonë mjekësor që ne ofrojmë për ta.

Unë inkurajoj të gjitha femrat të kenë besim në vete, të jenë të përgjegjshme të marrin njohuri dhe guxim për t'iu bashkangjitur FSK-së, sepse FSK-ja ofron mundësi të mëdha për shkollim të vazhdueshëm dhe karrierë të sigurt.

Një moral i lartë njerëzor, një përgjegjësi dhe përkushtim i madh për punë, çdo herë të bënë të jesh e suksesshme, pavarësisht barrierave dhe vështirësive gjatë punës, që mund t'i hasim. Të jesh këmbëngulëse në arritjen e qëllimeve tuaja. Ne mundemi, dimë dhe ia dalim.



Forca e Sigurisë së Kosovës

Manushaqe Nura

Pozita: Nëntogere, Komandante Togu, Batalioni i Tretë i Reagimit të Shpejtë

Unë jam Oficere me gradën e Nëntogerit dhe kryej detyrën Udhëheqës Togu. Detyrat e mia janë që të përkujdesem për aftësimin e pjesëtarëve në kryerjen e detyrave në bazë të misionit të FSK-së. Unë gjithashtu kujdesem dhe mbaj përgjegjësi për mirëqenien e tyre brenda dhe jashtë kazermës, nivelin e tyre disiplinor, zhvillimin personal dhe me një kujdes të veçantë e përcjell zhvillimin e karrierës së tyre në të ardhmen.

Pjesa më e mirë e bartjes së uniformës është privilegji që më është dhënë nga populli si bartëse e amanetit të dëshmorëve dhe martirëve të kombit, që rrugën drejt ndërtimit dhe zhvillimit shtetëror ta qojmë deri në fund.


Asnjëherë nuk humbas kohën time të vlefshme duke analizuar dallimet gjinore. Unë mendoj që barazinë e përcakton puna dhe përkushtimi, prandaj unë ndjem e barabartë dhe shpeshherë edhe në avantazh të madh ndaj kolegëve të mi meshkuj.

Profesioni i ushtarakut është i veçantë vetëm për faktin se në radhë të parë vihet shërbimi. Kjo nuk do të thotë se ky profesion ta kufizon përkushtimin ndaj familjes dhe jetën private në përgjithësi. Përkundrazi të jesh ushtarak do të thotë që të jesh shumë i përgatitur edhe në ballafaqimin me jetën civile. Njerëzit që ushtrojnë këtë profesion janë shumë të përgjegjshëm ndaj familjes dhe shoqërisë.

Respekti për femrat në uniformë në përgjithësi nuk mungon, por unë mendoj që qytetarët duhet të vetëdijësohen më shumë rreth faktit se në ditët e botës moderne prezenca e femrës në ushtri është e domosdoshme.

Pjesë vitale e një shteti të pa mposhtur është një ushtri e pa mposhtur, prandaj pa dilema ju lus që t'i bashkëngjiteni FSK-së, në ndërtimin e një ushtrie profesionale, që do ta ndërronte një herë e përgjithmonë rrjedhën e hidhur të historisë sonë.

Dashuria për atdheun duhet të jetë e pa kusht. Kur them dashuri për atdheun mendoj në punë, nder, guxim personal, respekt të ndërsjellë, integritet dhe besnikëri ndaj vlerave të kombit.





Forca e Sigurisë së Kosovës

Nita Vula

Pozita: Tetare, Deminere në Kompaninë e Deminimit

Unë kryej detyrën e Deminieres për Pastrimin e Minave të mbetura nga lufta e fundit në Kosovë. Kjo është një punë shumë e vështirë dhe me rrezik të madh, andaj mund t'ia kenë frikën edhe shumë meshkuj. Megjithatë, unë e bëj këtë punë me një vullnet dhe dëshirë shumë të madhe, pasi që e di rëndësinë e pastrimit të zonave të minuara.

Për mua është privilegj i madh të bartë uniformën e FSK-së dhe të jap vlera për vendin tim. Një femër që bartë uniformë ka një rëndësi mjaft të madhe për popullin e Kosovës, pasi që u jep shpresa popullit për të ardhmen e vendit.

Gjatë kryerjes së detyrës unë ndjehem shumë e barabartë me kolegët e mi meshkuj, por ndonjëherë ka raste që kursehem nga disa detyra me një rrezik shumë të lartë dhe që kryhen me vështirësi. Tek kolegët e mi gjithmonë gjej një mbështetje dhe respekt për punën time sa të vështirë aq edhe fisnike.

Puna ime nuk më pengon aspak në jetën time private. Për mua prioritet është t'i kryej obligimet profesionale në mënyrën më të mirë të mundshme, e pastaj të e koordinoj sa më mirë jetën time private. Obligimeve profesionale u përkushtohem gjatë orarit të punës 5 ditë në javë, duke i kryer të gjitha detyrat që më jepen, ndërsa jeta private është komplet një pjesë tjetër që më takon mua dhe koha që më mbetet në dispozicion mjafton.

Unë besoj se qytetarët e Kosovës e vlerësojnë kontributin e femrave në FSK, duke pasur gjithmonë parasysh se femrat janë një vlerë e veçantë që kanë vendosur t'i shërbejnë vendit në mënyrën më fisnike.

Të gjitha femrat që dëshirojnë të bëhen pjesë e FSK-së, të mos kenë dilema rreth këtij vendimi, pasi që të jesh pjesëtare këtu është një ndjenjë e mirë dhe shumë e veçantë. Të bartësh uniformën e FSK-së do të thotë që ti je e gatshme që t'i shërbesh vendit tënd në një mënyrë shumë të veçantë dhe të bëhesh pjesë e një të ardhme sa më të ndritur për vendin tonë.

Vendosmëria për të qenë pjesëtare e FSK është një element kyç për një femër. Pastaj duhet të ndjehesh e fuqishme që të përballesh me të gjitha sfidat që mund të vijnë gjatë punës.



Forca e Sigurisë së Kosovës

Jasmina Shabanovic

Pozita: Ushtare, Detyra të Përgjithshme në Kompaninë 2C të Batalionit të Dytë të Reagimit të Shpejtë

Punoj në administratë të Kompanisë 2C, Brigada e Reagimit të Shpejtë, Batalioni i 2-të në Istog. Përgjegjësia ime është rregullimi i dokumenteve të nevojshme për funksionimin administrativ të një kompanie. Po ashtu, bashkë me kolegët e mi, marr pjesë në marshime, ushtrime fushore, në trajnime të ndryshme të brendshme dhe institucionale, etj. Për momentin jam e angazhuar në fushatën e rekrutimit të pjesëtarëve të rinj, kështu që FSK-ja edhe në njëfarë mënyre më ka mundësuar prezantimin e uniformës në mënyrë edhe më të mirë.

Bartja e uniformës për mua është nder dhe privilegj. Më pëlqen dukja ime në uniformë, sepse në sytë e popullit prezantoj ushtarin që i shërben popullit të vet. Po ashtu, një femër në uniformë ka një vlerë shumë të madhe dhe i jep shumë shpresë popullit të Kosovës. Uniforma çdo herë bie në sy të popullit, posaçërisht nëse atë uniformë e ka një femër me qëndrim ushtarak.

Në raport me koleg kam shumë respekt dhe tek ta gjej mbështetjen për çdo gjë.

Puna ime nuk më pengon në jetën civile jashtë punës, pa marrë parasysh a jam duke shërbyer në punë apo jashtë orarit. Gjatë ushtrimeve fushore ne i përkushtohemi punës tonë 24:00 orë. Shërbimi në FSK më ka mundësuar respektin edhe më të madh nga njerëzit që më rrethojnë, gëzoj një admirim në sytë e popullit të Kosovës edhe kur jam civil. Në çdo moment kujdesem për sjelljet e mia, sepse e di që edhe në jetën civile, unë jam ushtar që i shërben popullit dhe shtetit të Kosovës.

Qytetarët nuk janë mjaft të njoftuar për prezencën e femrave në FSK dhe për atë arsye janë të befasuar me figurën e një femre në uniformë. Duhet cekur se një femër në uniformë është një figurë e këndshme dhe e respektueshme nga civilët. Qytetarët janë të vetëdijësuar për rëndësinë e uniformës që e mban një femër dhe për prezencën e tyre në ushtri.

Të gjitha femrat që dëshirojnë të bëhen pjesë e FSK-së u propozoj që të mos kenë dilema rreth kësaj pune, sepse kjo punë është sfiduese, por edhe ka shumë momente të bukura krenarie.

Një femër duhet patjetër të jetë e vendosur së pari të bëhet pjesë e FSK-së dhe të ndiej veten të fuqishme të ballafaqohet me të gjitha sfidat. Duhet të jetë e vetëdijësuar për rëndësinë që e ka ajo në uniformë dhe për nderin që e ka për të mbajtur atë. Ajo të jetë ushtarake në sy të popullit, të prezantoj kulturën e një familje të denjë dhe përkushtimin që e ka ndaj punës së saj.





Dogana e Kosovës

Krenare Shala

Pozita: Udhëheqëse e njësitit – Grada OD3

Me profesion jam juriste dhe punoj në sektorin për procedura dhe këshilla ligjore në kuadër të Departamentit Ligjor dhe të burimeve njerëzore. Merrem kryesisht me fushën e legjislacionit, ofrimin e këshillave ligjore, interpretimin e dispozitave të legjislacionit, gjithashtu jap këshilla ligjore, interpretime ligjore, draftimin e akteve nënligjore, etj.

Bartja e uniformës është e obligueshme, njëkohësisht duhet kuptuar si privilegj dhe ndiej përgjegjësi për shërbim më cilësor në kuadër të institucionit.

Po gjithsesi, pasi që kryejmë punë të njëjta, kemi pozita të njëjta, po ashtu jemi shumë të respektuara nga kolegët meshkuj, andaj me plot kuptimin e fjalës mund të them se në institucionin tonë ka respekt dhe barazi gjinore.

Meqenëse punoj me orar administrativ (8 orë), mundohem që krahas obligimeve dhe detyrave zyrtare të mos mbetem anash, si në aktivitete jashtë pune, gjithashtu edhe në obligimet familjare si një nënë që jam kam përkrahjen permanente të familjes.

Vlerësimi nga qytetarët për kontributin e femrave në uniformë është relativ, niveli i përkrahjes mund të jetë më i lartë.

I inkurajoj femrat që kanë ende dilema se me të vërtetë është një krenari dhe kënaqësi të jesh zyrtare e uniformuar. Si çdo pozitë tjetër edhe pozita në uniformë është një sfidë në kryerjen e detyrave dhe njëkohësisht është krenari dhe kënaqësi.

Besimi në vetvete, vullneti, përkushtimi ndaj punës dhe profesionalizmi, mendoj se janë elementet qenësore dhe çelës i suksesit të dëshiruar.

Shenaj Ymeri

Pozita: Zyrtar i Lartë Doganor

Në kuadër të pozitës që ushtrij, detyrat dhe përgjegjësitë janë kryesisht të natyrës që kanë të bëjnë me analizimin, përpunimin, vlerësimin e të dhënave të importeve dhe eksporteve, identifikimin dhe parandalimin e parregullsive që shfaqen gjatë dhe pas procedurës së zhdoganimit të mallrave. Gjithashtu, në kuadër të marrëveshjeve, bashkëpunoj me agjencitë tjera të zbatimit të ligjit.

E konsideroj si privilegj të jem pjesë e stafit me uniformë, apo pjesë e suksesit në shërbim të qytetarëve. Gjithashtu, bartja e uniformës në vetë bartë edhe përgjegjësi pasi që duhet të zbatohet në përpikëri, t'i përcjellim ndryshimet, trendët dhe zhvillimet, me qëllim të ofrimit të një shërbimi sa më transparent dhe efikas.

Si vlerë themelore e zhvillimit të demokracisë është edhe barazia ndërmjet gjinive. Për t'i arritur qëllimet dhe objektivat e parapara sipas planeve strategjike, gjatë ushtrimit të detyrave, ndihem plotësisht e barabartë me kolegët e gjinisë mashkullore.

Menaxhimin e kohës dhe koordinimin e obligimeve profesionale me ato të jetës private, e bëj duke i përcaktuar disa parime, sinë punë ashtu edhe në jetën private. Ndër parimet të cilat më shërbejnë për menaxhimin e kohës janë: përcaktimi i prioritetëve, planifikimi edhe organizimi i punëve të cilat duhet të kryhen në afate të caktuara, vendosja e qëllimeve.

Mendimet dhe vlerësimet nga qytetarët janë të ndryshme. Bazuar në përvojën time si një zyrtare e uniformuar, për kaq vite sa jam pjesë e Doganës së Kosovës, mendoj se qytetarët e vlerësojnë në mënyrë pozitive kontributin e uniformës dhe sigurosh ata i kanë ndjerë efektet pozitive në shoqëri.

Për ndërtimin e një shteti demokratik dhe ligjor, ku të drejtat e qytetarëve janë të mbrojtura dhe të garantuara me aktin më të lartë të shtetit, kontributi i femrave është i domosdoshëm për një zhvillim më të mirë politik, ekonomik, social dhe kulturor.

Një femër që të jetë e suksesshme duhet së pari të ketë vetëbesim, vullnet për punë, duhet të tregoj përkushtim gjatë kryerjes së detyrave, të jetë profesionalisht e përgatitur dhe ta respektoj kodin etik.





Dogana e Kosovës

Valbonë Ymeri

Pozita: Udhëheqëse Njësitit në Hetime

Punoj si Udhëheqëse e Njësitit në Sektorin e Hetimeve të Doganës së Kosovës, ku hetoj raste të ndryshme, bëj intervistime, bastisje të lokaleve dhe shtëpive, të kërkesave të ndryshme, zbatimin e urdhërësive, përpilimin e kallëzimeve, përpilimi i raporteve të veçanta për Prokurori etj.

Çdo institucion i Republikës së Kosovës ka përgjegjësitë e veta, por personat e uniformuar kanë dy përgjegjësi, një të punës që e bëjnë edhe tjetra është bartja e uniformës e cila është përgjegjësi në vete, në momentin që ne veshim uniformën nuk përfaqësojmë vetëm vetën tonë si person, por përfaqësojmë edhe institucionin.

Them se ndihemi të barabartë me përgjegjësi të plotë, sepse deri më tani në kryerjen e punëve të cilat na takojnë në kuadër të detyrës zyrtare, asnjëherë nuk jam ndier që nuk jam e barabartë me kolegët meshkuj por çdo herë kemi pas një komunikim të shkëlqyeshëm mes veti dhe çdo herë ndihmojmë njeri tjetrin.

Me vullnet, dashuri dhe përkushtim të madh për punën, duke mos e anashkaluar në asnjë moment përkrahjen e madhe të familjes, mund të arrij në koordinimin e obligimeve profesionale dhe jetës private. Unë mendoj që qytetarët e vlerësojnë në mënyrë pozitive kontributin e femrave në uniformë.

Femrave që dëshirojnë të kenë pozita me uniformë, vetëm le të zgjedhin profesionin që ato duan dhe asnjëherë mos të hezitojnë të jenë pjesë e uniformës, sepse uniforma nuk është pengesë që të arrij në një karrierë të suksesshme.

Unë mendoj që për të qenë e suksesshme në secilën punë së pari duhet me e dashtë dhe me vlerësuar punën, energji pozitive, angazhim, përkushtim të madh dhe suksesi nuk do të mungojë asnjëherë.



Dogana e Kosovës

Luljeta Spahiu

Pozita: Zyrtar Doganor

Unë si zyrtare doganore jam e sistemuar në Aeroportin Ndërkombëtar "Adem Jashari" në arritje dhe kam për detyrë t'i kontrolloj pasagjerët dhe bagazhin e tyre, po ashtu të shqiptoj kundërvajtje doganore dhe gjoba administrative doganore.

Bartjen e uniformës e konsideroj privilegj dhe përgjegjësi, si dhe mundohem që detyrat e mia t'i kryej në bazë të kompetencave dhe përgjegjësi ligjore, gjithmonë duke respektuar edhe uniformën e institucionit.

Bashkëpunimi me kolegët meshkuj është shumë i mirë, ata janë mjaft miqësorë dhe ne na respektojnë, gjë që përbën thelbin e çdo aktiviteti të organizatës tonë.

Me përkushtimin më të madh edhe pse është mjaft e vështirë, mundohem që të ndaj kohën edhe për familjen time dhe obligimet familjare.

Me vetë faktin kur qytetarët na shohin femra me uniformë na përgëzojnë për përkushtimin tonë dhe na respektojnë për punën që bëjmë.

Të jesh në shërbim të qytetarëve është mundësia jote më e madhe dhe gjinia asnjëherë nuk është pengesë që ju të ushtroni funksionin tuaj.

Të jetë e përkushtuar gjatë ushtrimit të detyrave, të ketë vullnet, guxim dhe durim.





Shërbimi Korrektues i Kosovës

Shpresa Bllacaku

Pozita: Zyrtare Korrektuese në Sektorin e Sigurisë

Në kuadër të pozitës sime kam disa detyra dhe përgjegjësi, pasi që unë jam oficer e sigurimit dhe jam përgjegjëse për shumë detyra që i përkasin sektorit të sigurimit, si kontrollimin e gjithë hapësirës brenda pavionit, pajisjeve të sigurisë, për funksionalitetin e tyre, përcjelljen e vizitave të burgosurve me avokatë, familjarë, si dhe bastisje gjatë çdo hyrje-dalje të burgosurve dhe vizitorëve (të gjinisë femërore).

Uniforma me bënë më autoritare gjatë kryerjes së detyrave, por gjithsesi e konsideroj edhe si privilegj që kam pasur mundësinë të jem pjesë e Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Ndihem, dhe jemi të barabartë në punë, pasi që kemi detyra dhe përgjegjësi të njëjta, sikurse meshkujt ashtu edhe femrat. Bashkëpunimi dhe përkrahja e kolegëve meshkuj neve na bënë edhe më të suksesshme.

Me një koordinim të mirë të punëve, arrij t'i kryej të gjitha detyrat me përgjegjësi të plotë, poashtu edhe obligimet e mia familjare, pasi që jam nënë, bashkëshorte dhe kam përkrahje të plotë nga familja ime.

Mendoj që puna e femrave në uniformë vlerësohet nga qytetarët, por jo edhe aq sa është kontributi i tyre.

Mos hezitoni, largoni dilemat dhe vendosni për pozita në të cilat duhet bartur uniforma, pasi që edhe ne femrat mund të japim kontributin tonë edhe në këto institucione si çdokund tjetër, do të keni përkrahje institucionale poashtu do të keni përkrahje edhe nga familja.

Çdo femër e arsimuar dhe që ka vetëbesim, mendoj se do të ketë sukses në një profesion të tillë dhe në këto institucione të rëndësishme shtetërore, pasi që e kemi mundësinë të cilën nuk e kanë pasur gjeneratat e mëhershme.



Shërbimi Korrektues i Kosovës

Fatlinda Mustafa Vuniqi

Pozita: Mbikëqyrëse në Zyrën Ekzekutive

Koordinoj pranimin dhe lirimin e të burgosurve sipas ligjit dhe rregulloreve të burgut, bazuar në Aktgjykimin apo Aktvendimin nga Gjykatat, verifikimi i identitetit të burgosurve, kalkulimi i dënimit, futja e të dhënave në data bazën e burgut, ruajtja e dosjeve të burgosurve, si dhe përgatitja e lëndëve për panelin e lirit me kusht.

Është privilegj i madh të bartësh uniformën e institucioneve të shtetit të Kosovës, ka qenë ëndërr e imja që nga fëmijëria që të jem pjesë e uniformës shtetërore, e cila më është realizuar.

Në punë detyrat dhe përgjegjësitë janë të njëjta për gjithë stafin qoftë për femra apo meshkuj dhe gjithherë me një bashkëpunim kolegjial, arrijmë të jemi të suksesshëm.

Menaxhimi i drejtë i kohës gjatë periudhës së orarit të punës më jep mundësi të koncentrohem në detyrat dhe obligimet dhe t'i kryejë me sukses, poashtu arrij që të organizoj edhe jetën time private pasi jam nënë dhe bashkëshorte.

Vlerat, arritjet në punë, sukseset, qëndrimet, gjykimet dhe sjelljet tona ndaj të tjerëve, mbetet të vlerësohen nga qytetarët. Ato pasqyrojnë atë që është e rëndësishme për secilin prej nesh si individ. Vlerat tona të vërteta reflektohen në sjelljet tona në punë, në rrugë dhe gjithkund.

Për femrat të cilat e konsiderojnë arsimimin dhe edukimin si element primar të jetës, duhet të shtyjnë më tutje ëndrrat e tyre dhe të shtojnë kurajën që t'i bashkëngjiten kolegeve të tjera në uniformë. Prandaj femrat duhet të mos kenë dilema, ngase mund të punojnë, të jenë të suksesshme, të avancohen në pozita sikurse meshkujt edhe në këto institucione.

Çdo njeri gjatë jetës së tij përballlet me sfida të ndryshme, qofshin ato të mëdha apo të vogla, por njeriu ia del mbanë nëse ka besim në vetvete dhe durim, poashtu nëse e do uniformën, besoj se do të arrijnë të jenë të suksesshme në çdo sferë të jetës.





Shërbimi Korrektues i Kosovës

Jelena Cvejiq

Pozita: Zyrtare Korrektuese në Njësitin e Transportit

Detyrat dhe përgjegjësitë në kuadër të pozitës që kryej është vëzhgimi dhe kontrollimi i të burgosurve, lëvizjet dhe sjelljet e tyre, dhe siguria maksimale gjatë shoqërimit të tyre me njësitin e transportit jashtë institucionit si në gjykata, në vizita mjekësore apo në vizita humanitare.

Për mua është privilegj që më është dhënë besimi të punoj si grua në uniformë në këto institucione shtetërore, prandaj detyrat e mia i kryej me një përkushtim të madh.

Gjatë kryerjes së detyrave të mia absolutisht jam e barabartë me kolegët meshkuj, për arsye se trajnimin të cilin e kam kryer për zyrtarë të njësitit të transportit është i njëjtë për të gjithë pa dallim gjinie. Edhe detyrat dhe përgjegjësitë që i kryejmë si ekip gjatë orarit të punës janë të barabarta për të gjithë ne në njësi.

Si grua që punoj punën të cilën e dua, nuk e kam problem që të organizoj jetën private dhe atë profesionale, që nënkupton se derisa jam në punë dhe kryej detyrat zyrtare privatësia ime për mua është maksimalisht e shkëputur dhe përqendrohem në obligimet profesionale, ndërsa pas orarit të punës mund t'i kryej të gjitha obligimet e mia familjare.

Unë besoj se një përqindje e vogël e qytetarëve nuk e vlerësojnë sa duhet kontributin e gruas në uniformë.

Nga përvoja ime si grua në uniformë, do të inkurajoja gratë që ti bashkëngjiten Shërbimit Korrektues të Kosovës, pa asnjë dilemë në mënyrë që të tregojnë vlerat e tyre, të japin kontributin edhe në këto institucione.

Sipas meje gruaja në uniformë që të jetë e suksesshme duhet të jetë e edukuar, e aftë psikikisht dhe fizikisht, komunikative, të ketë vetëbesim dhe të dojë punën që kryen.



Shërbimi Korrektues i Kosovës

Valdete Bunjaku

Pozita: Zyrtare Korrektuese

Mbikëqyr, kontrolloj, monitoroj lëvizjet e të burgosurve dhe aktivitetet brenda dhe jashtë institucionit në raste të përcjelljes apo shoqërimit në gjykata, vizita humanitare dhe vizita shëndetësore, duke respektuar dinjitetin e tyre dhe gjithherë duke u bazuar në rregulloret e brendshme të Institucionit Korrektues.

Bartja e uniformës më bënë të ndihem më autoritare gjatë orarit të punës, përndryshe pas orarit të punës i kryej obligime familjare si çdo femër tjetër.

Sigurisht që gjatë detyrave ndihem e barabartë me kolegët me të cilët e kryejmë punën e përbashkët, dhe si të gjithë pa marrë parasysh, femër apo mashkull, e kryejmë atë punë që na parashtrohet gjatë orarit të detyrave tona të përditshme.

Gjithsesi me një angazhim të përkushtuar arrij që në mënyrë perfekte t'i koordinoj detyrat e mia gjatë orarit të punës dhe jetës private.

Unë mendoj që qytetarët e kanë një respekt të veçantë ndaj uniformës, sidomos ndaj femrave të cilat mbajnë këtë uniformë.

Kam porosi për femrat që e duan uniformën, që mos të kenë dilema, të mos të hezitojnë të marrin pozita të tilla, të japin kontributin e tyre, ngase mund të jemi të suksesshme edhe në këto institucione. Bartja e uniformës tregon se i shërben një institucioni me vlera të larta qytetare.

Një femër duhet të ketë aftësi profesionale, të ketë vlera të etikës dhe sjelljes sa më të mira ndaj institucionit dhe të kryej detyrat në mënyrë profesionale, aty ku edhe është e paraparë dhe të kanë sa më shumë bashkëpunim, koordinim të punëve me kolegë dhe kolege në atë institucion ku edhe kryhen punët e përditshme.





Policia e Kosovës

Arjeta Xhosha

Pozita: Mbikëqyrëse e Ekipit Reagues

Unë punoj në Stacionin Policor Jugu në Mitrovicë, me gradë jam Togere dhe aktualisht jam mbikëqyrëse e Ekipit Reagues. Detyrat dhe përgjegjësitë e mia kanë të bëjnë me mbikëqyrje të ekipit tim, ndarjen e detyrave për policët që veprojnë në teren, përcaktimi i prioritetëve të punës, etj.

Me vet faktin se ne punojmë në uniformë jemi persona të cilët kemi dhe e gëzojmë autoritetin, kjo gjithmonë duke u bazuar në suaza ligjore të cilën autoriteti na lejon, kufi ky që asnjëherë nuk duhet tejkaluar. Njëkohësisht bartja e uniformës është privilegj.

Fatmirësisht te ne ekziston një raport i shëndoshë dhe i mirëfilltë me kolegët e gjinisë së kundërt dhe të dyja palët e kuptojmë shumë mirë njëri tjetrin. Lodhjen dhe stresin e punës e kemi emëruar të përbashkët, por kemi edhe momentet shumë të mira të suksesit të punës të cilat i ndajmë bashkë.

Puna me ndërrime dhe jashtë orarit të punës, janë të shpeshta, kjo bën që kohën ta kemi shumë të limituar dhe shumë pak kohë mbetet për t'ia kushtuar jetës private. Pavarësisht kësaj, në fund të orarit të punës janë më të dashurit e mi, fëmijët, bashkëshorti dhe familja e tjerë të cilët më presin me shumë dashuri dhe kohën e mbetur ia përkushtoj atyre dhe kjo më jep kënaqësi, përkrahje dhe vullnet për të vazhduar më tutje.

Qytetarët janë të bindur në korrektësinë, besimin dhe kontributin tonë që ne e kemi dëshmuar tashmë. Kemi krijuar një atmosferë shumë të favorshme në komunikim me qytetarët, andaj për mua është kënaqësi që sa herë të dalë në rrugë qytetarë të shumtë na përshëndesin dhe flasin me një ngrohtësi.

Femrat duhet ta sfidojnë veten, prania e femrës në Polici, e sidomos në pozita menaxheriale do të ndikon pozitivisht në ngritjen e profilit dhe pozitës së gruas në përgjithësi, sepse ne dimë, duam dhe ia dalim!

If not us, then who?
If not now, then when?

Për tu bërë police, fillimisht duhet ta dojë profesionin e police, më pas duhet të ketë vetëbesim, të jetë fleksibël dhe e motivuar, të ketë karakter të fortë, pasi që puna e policisë është me shumë sfida.



Policia e Kosovës

Naxhije Gashi

Pozita: Operatore/Njësia për Mbrojtje të Afërt

Në kuadër të punës sime si pjesëtare në Njësitin për Mbrojtje të Afërt në Policinë e Kosovës, kërkohet që të jem e përkushtuar dhe e përgjegjshme. Detyrat e mia janë që të ofroj përcjelljen dhe sigurimin e personaliteteve vendore dhe ndërkombëtare. Këtë pozitë e bën më të veçantë numri i pakët i femrave që janë të angazhuara në kuadër të këtij njësi.

Si çdo kolege e imja, edhe unë si pjesëtare e Policisë së Kosovës, bartjen e uniformës e konsideroj privilegj dhe është nderë që të jem në shërbim të qytetarëve dhe vendit tim.

Që nga momenti i angazhimit në Policinë e Kosovës dhe gjatë kryerjes së detyrave të përditshme, çdo herë kemi qenë të barabarta me kolegët e gjinisë mashkullore, në ndarjen e punëve dhe përgjegjësi.

Krahas përgjegjësi profesionale, mundohem të balancoj edhe jetën time private dhe të bëj një menaxhim të suksesshëm të kohës, ngase nga balancimi i mirë më bën që të jem e suksesshme në punën time dhe t'i dal ballë përgjegjësi dhe sfidave që më paraqiten.

Vitet e para pas themelimit të Policisë së Kosovës, ndoshta ka qenë pak e vështirë që qytetarët të mësohen me rolin e femrës police, por sot besoj që me punën dhe përkushtimin tonë, kemi arritur të fitojmë respektin e tyre.

Çdo profesion apo punë kërkon përkushtim, mirëpo asnjëherë profesioni im nuk më ka penguar as në anën time private, kështu që u kisha sugjeruar të gjitha femrave që dëshirojnë të jenë në uniformë të gjejnë kurajë dhe pa asnjë dilemë t'i bashkohen familjes së madhe të Policisë së Kosovës.

Puna ime në kuadër të Njësitit për Mbrojtje të Afërt ka specifikat e veta të veçanta, përveç që duhet të kesh vlerat elementare për të qenë pjesëtare e uniformuar, duhet të kesh guxim, përkushtim dhe vigjilencë në çdo kohë.





Policia e Kosovës

Gylten Kajmakci

Pozita: Zyrtare në Ekipin Reagues

Pasi punoj në Njësitin Reagues, detyrat dhe përgjegjësit e mia në kuadër të pozitës janë që, menjëherë pas marrjes së informatës lidhur me ndonjë vepër të mundshme, sa më shpejtë t'i përgjigjemi rastit. Varësisht sipas natyrës së rastit, ne kontaktojmë me viktimë, identifikojmë dëshmitarët, mbledhim dëshmitë, arrestojmë të dyshuarit dhe procedojmë rastin për hetime të më tutjeshme.

Bartja e uniformës është përgjegjësi ngase është profesion shumë i ndjeshëm, mirëpo në të njëjtën kohë të jesh afër atyre që kanë nevojë më së shumti është përgjegjësi dhe ndjenjë madhore

Femrat njëjtë si meshkujt, janë pjesë e pazëvendësueshme e sukseseve të Policisë së Kosovës.

Nuk është fare e lehtë të jesh bashkëshorte dhe nënë e përkushtuar për familjen tënde. Besoj se secila nga ne duhet të gjejë energji shtesë që maksimalisht të japim kontributin tonë si në jetën private ashtu edhe në kryerjen e detyrave policore. Këtë e bëjnë të mundur dëshira ime që të jem sa më afër qytetarëve të cilët kanë nevojë për ne.

Ky besim nuk më është lëkundur tash e 15 vite të shërbimit tim. Unë vlerësoj lartë respektin dhe besimin që qytetarët tanë kanë për femrat police.

Personalisht inkurajoj çdo grua e cila sadopak e pëlqen uniformën dhe brenda vetes do të plotësohet nëse angazhohet në një profesion të tillë.

Çdo grua që dëshiron të ushtroj profesion në uniformë, besoj se duhet të ketë vlera të larta morale dhe profesionale, karakter të palëkundshëm, të jetë pa paragjykime, të ketë aftësi të mira komunikuese dhe vullnet për punë.



Policia e Kosovës

Nejma Colakovic

Pozita: Udhëheqëse e Ekipit të Hetimeve

Përgjegjësia ime është mbikëqyrëse në kuadër të Departamentit të Hetimeve të Policisë së Kosovës, dhe jam udhëheqëse e ekipit, ku përfshihen shumë punë rreth çështjeve administrative dhe organizative. Kemi një bashkëpunim të ngushtë me të gjitha ekipet dhe njësitë në sektorin rajonal për hetime, pastaj mbikëqyri dhe kujdesem për oraret e punës etj.

Profesionin tim e konsideroj profesion të veçantë, andaj më bëjnë të ndihem mirë gjatë performancës së detyrave dhe përgjegjësi të mia.

Gjithmonë ndihem e barabartë me kolegët meshkuj dhe ashtu edhe vepro. Ne kemi një respekt të ndërsjellë, gjithmonë duke ndihmuar në punët e përditshme profesionale.

Mundohem në të gjitha mënyrat t'i përmbahem agjendës sime dhe këtë menaxhim e bëj në mënyrën më të mirë të mundshme.

Qytetarët kanë besim në ne, jam shumë e bindur për këtë, pasi kjo vërehet edhe gjatë punës tonë në terren.

Grave që dëshirojnë të jenë pjesëtare të uniformës ju them të mos hezitojnë, por të bëhen pjesë e saj. Kështu, do të japin një kontribut të madh për të ardhmen e vendit.

Gruaja që dëshiron të jetë pjesëtare e uniformës duhet të jetë e edukuar, e shkolluar, si dhe të ketë një prapavijë të pastër.





Forca e Sigurisë së Kosovës

Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) është Forcë e re, profesionale, shumetnike, lehtë e armatosur dhe e uniformuar. Misioni i FSK-së është që të kryej operacionet e reagimit ndaj krizave në Kosovë dhe jashtë saj.

Numri i përgjithshëm i stafit të FSK-së është 2500 pjesëtarë aktivë dhe 800 pjesëtarë rezervë, prej të cilëve, 208 janë gra.



Dogana e Kosovës

Dogana e Kosovës është agjenci ekzekutive e Ministrisë së Financave. Dogana e Kosovës ka një mision të gjerë, duke filluar nga forcimi i ekonomisë së shtetit etj.

Numri i përgjithshëm i grave që punojnë në doganë është 132.



Shërbimi Korrektues i Kosovës

Shërbimi Korrektues i Republikës së Kosovës është organ qendror i administratës shtetërore, profesional, i pavarur, i uniformuar me grada dhe pjesërisht i armatosur, në vartësi të Ministrisë së Drejtësisë.

Numri i përgjithshëm i stafit në Shërbimin Korrektues të Kosovës është 1605 prej tyre 111 janë femra në uniformë.



Policia e Kosovës

Policia e Kosovës është agjenci ekzekutive e Ministrisë së Punëve të Brendshme, e cila merret me zbatim të ligjit në Kosovë.

Numri i përgjithshëm i stafit të Policisë së Kosovës është 8693, prej tyre 1248 janë gra.

Projekt i përbashkët i Zyrës së Informimit Publik të Ministrisë për Punë të Brendshme, Ministrisë për Forcën e Sigurisë, Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Drejtësisë.

Koordinator i këtij projekti është Shoqata e Grave të Policisë së Kosovës.

Katalogu është mbështetur financiarisht nga Ambasada e Mbretërisë së Norvegjisë në Prishtinë. Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura këtu nuk pasqyrojnë ato të Ambasadën e Mbretërisë së Norvegjisë.